



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:241382

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05733658

P.nr..../...

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrje të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit B..... B....., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II nr.989/22 të datës 16.11.2022, jashtë seancës gjyqësore me datë bie këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr..../. e datës, lidhur në mes të pandehurit B..... B..... dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K..... –sha, me seli në Pejë.

II. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore ne Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II nr. 989/22 të datës 16.11.2022.

III. PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit B..... B....., i lindur me në P....., Rr V..... D....., i identifikuar ne baze te letërnjoftimit me nr. i lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

- për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshme me datën 26.10.2022 ka ngritur aktakuzën PP/II nr.989/22, të datës 16.11.2022, ndaj të pandehurit B..... B..... për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Me datën është arrit marrëveshja në zyrën e ndërmjetësimit në mes të pandehurit B..... B..... dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K.....-sha, me seli në Pejë, e cila marrëveshje i është dozuar gjykatës ne kopje të mjaftueshme.

Nga te cekurat me lartë gjykata ka vendosur si ne pikën I të dispozitiv të këtij aktvendimi duke e pranuar marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr..../... e datës, lidhur në mes të pandehurit B..... B..... dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K.....-sha, me seli në P..., e cila marrëveshje i është dozuar gjykatës ne kopje të mjaftueshme.

Me dispozitën ligjore të nenin 229 par. 5 të KPRK-së është përcaktuar se: nëse aktakuza është dorëzuar, gjyqtari i vetëm gjykues, nëse e pranon formalisht marrëveshjen, merr vendim për të hedhur aktakuzën dhe e ndërpre në procedurën penale.

Andaj nga të cekurat më lartë e në kuptim 229 par.5 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,
DIVIZIONI PENAL
2022:241382, 24.05.2024**

Bashkëpunëtorja Profesionale

Gj y q t a r i

Edona Berisha Kastrati

Musë Povataj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë te drejtë të parashtrajnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi